



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË**



Përmbledhje

E Mbledhjes së Shtatë të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP)

e cila u mbajt

të enjten, datë 16 Dhjetor 2021, nga ora 13:00 deri 15.00 organizuar virtualisht.

Në datën 16 dhjetor u zhvillua mbledhja e shtatë e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP). Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID 19 kjo mbledhje u zhvillua në mënyrë virtuale. Mbledhja u drejtua nga Kryetarja e këtij Komiteti, Zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë.

Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, si: Sekretari i Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Kryetarja e Komitetit Ndihmës të Pagesave, Kartave, Digjitalizimit dhe Kanaleve Alternative të krijuar rishtazi nga Shoqata Shqiptare e Bankave me qëllim mbështetjen e objektivave të KKSP, përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Shoqata Mikrofinanciare Shqiptare, si dhe institucione financiare jobanka, përfaqësues të operatorëve të skemave kombëtare të pagesave.

Gjithashtu, me qëllim përmbushjen e rolit katalizator të Komitetit si dhe angazhimin për zgjerimin e kapaciteteve institucionale në kuadër të përmbushjes së Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël, në mbledhje ishin të ftuar edhe një sërë aktorësh të rëndësishëm me qëllim mbështetjen e tematikave të zhvilluara gjatë mbledhjes ku mund të përmendet Banka Botërore.

Mbledhja u hap nga Kryetarja e KKSP Zj. Minxhozi, e cila në fjalën e saj hyrëse falënderoi pjesëmarrësit për mbështetjen aktive në kuadër të përmbushjes së objektivave të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me

Vlerë të Vogël (2018-2023). Zj. Minxhozi theksoi se pavarësisht faktit se nga pikëpamja kohore jemi ende në gjysmën e rrugëtimit përpjekjet tona të përbashkëta kanë reflektuar në një përmbushje shumë optimiste të synimeve të vendosura.

Në vijim, Zj. Minxhozi bëri një përmbledhje të masave të realizuara deri më tani, duke u fokusuar si në kuadër të zhvillimeve ligjore e rregullative, të tilla si: hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, miratimi i kuadrit rregullativ “Për Debitimin Direkt” dhe hartimin e projekt-ligjit “Për llogarinë bazike”, ashtu edhe nga pikëpamja e zhvillimeve infrastrukturore. Në këtë drejtim Zj. Minxhozi i kushtoi vëmendje projektit “Për shlyerjen e pagesave në euro brenda vendit” i cili tashmë është finalizuar si nga pikëpamja infrastrukturore ashtu edhe rregullative, dhe në fillim të vitit 2022 do të jetë funksional dhe i disponueshëm për aktorët e tregut. Kryetarja mbylli fjalën e saj duke theksuar edhe një herë rëndësinë që ka edukimi financiar për materializimin sa më efektiv të masave të ndërmarra deri më tani dhe për arritjen e objektivave në vijim.

Seksioni i parë i mbledhjes së shtatë filloi me analizimin e masave të marra deri më tani në kuadër të hartimit të Strategjisë Kombëtare për Edukimin Financiar. Në këtë drejtim aktorë të rëndësishëm si Banka e Shqipërisë e përfaqësuar nga Z. Altin Tanku, Drejtori i Departamentit të Kërkimeve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i përfaqësuar nga Zj. Mimoza Kaci, Z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Zj. Brunilda Isaj nga Shoqata Mikrofinanciare Shqiptare, në këtë nisëm shpjeguan masat e marra nga ana e tyre dhe këndvështrimet në lidhje me përfaqshjen dhe objektivat e strategjisë si dhe theksuan nevojën e mbështetjes së një nisme të tillë dhe angazhimin e tyre për promovimin e këtij objekti . Ky seksion përfundoi me një prezantim të detajuar nga Zj. Edlira Dashi përfaqësuese e Bankës Botërore, si partneri kryesor ndërkombëtar i cili po asiston aktorët shqiptarë në hartimin e strategjisë së edukimit financiar (2022-2027). Prezantimi u fokusua mbi detaje specifike të kësaj strategjie si: misioni, vizioni, nevoja dhe arsyet e strategjisë, aktorët, koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional si dhe burimet e financimit të kësaj strategjie.

Në vazhdim, mbledhja vijoi me një çështje mjaft të rëndësishme për tregun, por dhe për përmbushjen e Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël dhe që lidhet me kuadrin rregullativ në zbatim të ligjit “Për shërbimet e pagesave” i cili dikton kriteret dhe kërkesat që duhet të plotësojnë si institucionet ekzistuese ashtu dhe aktorët e rinj në treg. Një çështje me interes të veçantë ishte dhe rregullimi i komunikimit për APIs (*Application Program Interfaces*) dhe konceptin e bankës së hapur (*open banking*) dhe mbi autentifikimin e thelluar të klientit, elemente këto që plotësojnë të gjithë kuadrin e nevojshëm për promovimin e inovacionit në treg. Këto zhvillime u prezantuan nga z. Deniz Deralla, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë. Ky seksion paraqiti mjaft interes tek pjesëmarrësit

ku pati edhe diskutime me pyetje e përgjigje në lidhje me plotësimin e kushteve nga ana e subjekteve për licencim.

Në vazhdim, Zj. Ledia Bregu, Drejtor i Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, në lidhje me Strategjinë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël, prezantoi arritjet e deritanishme si dhe objektivat për tu përmbushur në vazhdim duke përmendur këtu edhe zhvillimet infrastrukturore, konkretisht operacionalizimin e pjesëmarrjes së institucioneve financiare jo banka në sistemin AECH. Në vazhdim u paraqitën arritjet në kuadrin e projektit të Debitimit Direkt (miratimin e rregullores “Për debitimin direkt” si instrument shërbimi pagese për konsumatorët dhe mikro-ndërmarrjet), dhe mbi Sistemin për Shlyerjen në Euro për pagesat ndërbankare në euro brenda vendit (Sistemi AIPS EURO).

Rekomandimet e mbledhjes së shtatë të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave.

1. Monitorimin e zbatimit të Ligjit 55/2020 “Për Shërbimet e Pagesave” dhe efekteve në treg në kuadër të përmbushjes së objektivave të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël
2. Vijimi i punimeve për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Edukimin Financiar. (aktorët e tregut të përfshirë në planin e veprimit të strategjisë)
3. Vijimi i punës për reduktimin e kostove të mbartura nga bizneset të cilat ofrojnë pagesa me kartë nëpërmjet programeve ndërgjegjësuese të kryera në bashkëpunim me Bankën Botërore .
4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël(2018-2023) dhe realizmi i objektivave të synuar.

Pjesëmarrja në mbledhje.

Anëtarët e KKSP në Mbledhjen e Shtatë			
Institucioni	Emri i Anëtarit	Statusi në KKSP	Përfaqësuar të tjerë të institucionit
Banka e Shqipërisë	Zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë	Kryetare	
Shoqata Shqiptare e Bankave	Z. Spiro Brumbulli/ Zj. Irida Huta	Anëtar/ Sekretariat	
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Zj. Adela Xhemali Zv. Ministër	Anëtar	
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)	Zj. Nevila Repishti Drejtor, e- Albania	Anëtar	
Ministria e Brendshme	Zj. Lorena Pullumbi	Anëtar	
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)	Zj, Mimoza Kaci	Anëtar	
Banka e Shqipërisë	Zj. Ledia Bregu, Drejtor, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës	Anëtar	Zj. Marsida Ganaj/Jubica
Banka e Shqipërisë	Z. Deniz Deralla, Drejtor, Departamenti i Mbikëqyrjes	Anëtar	
Banka e Shqipërisë	Z. Donald Duraj, Shefi i Kabinetit	Anëtar	
Banka e Shqipërisë	Z. Indrit Xhemali Drejtor i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit	Anëtar	
Banka e Shqipërisë	Z. Altin Tanku	Anëtar	
Paylink	Zj. Eneida Thomaj, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Z. Dritan Baholli
Unioni Financiar Tiranë	Z. Elton Çollaku, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	
Easy Pay	Zj. Linda Shomo Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	
MPay	Z. Ludovic Laventure, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Zj. Bora Ferri,

AK-Invest	Zj. Greis Ceku	Anëtar	
Posta Shqiptare	Z. Taulant Piero	Anëtar	
Paysera	Z. Ildir Ahmati	Anëtar	
Banka e Shqipërisë	Zj. Valentina Semi Zëvendës drejtor Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës	Sekretariat	
Pjesëmarrës të Tjerë			
Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a.	Zj.Elona Labinoti,		
Banka Kombëtare Tregtare sh.a.	Z.Kerem Pamuk,		
Banka Credins sh.a.	Z. Dimitri Toslluku,		
Banka OTP Albania sh.a	Zj. Irida Huta		
Banka Raiffeisen sh.a	Z. Resmi Hibraj		
Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.	Z. Adrian Guza,		
Banka Alpha Albania sh.a.	Z. Dritan Gucaj		
Banka Tirana sh.a.	Zj. Aida Gjoni		
Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.	Zj. Xhilda Shehu		
Banka Amerikane e Investimeve sh.a.	Zj. Odeta Paloka		
Banka Union sh.a.	Zj. Fatbardha Rino		
Banka Procredit	Zj. Aneda Smoqi		
Shoqata Mikrofinanciare Shqiptare	Zj. Brunilda Isaj		